



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 729/ 5 prot.

Datë 18.05.2023

V E N D I M
Nr. 389/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.05.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-60961-03-01-2023, me objekt “Qendra e Kreativitetit faza II” me fond limit 17,708,780.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.03.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë

Ankimues: BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company”dshh & Desaret Company” SHPK
Rruga “Xhorxh Martini” Nr. 20, Godina 11 kateshe, Shk.2,kati 7

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. BOE ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e BOE ankimues janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.03.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-60961-03-01-2023, me objekt “Qendra e Kreativitetit faza II” me fond limit 17,708,780.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.03.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 20.03.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 29.03.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company SHPK (Degë e shoqërisë së huaj RSM Company) dhe “Desaret Company” SHPK” 13.270.123 lekë, skualifikuar

2. “ZEQILLARI” SHPK	13.630.831,4 lekë	kualifikuar
3. “NIKA” SHPK	14.006.586,88 lekë	kualifikuar
4. “INA ” SHPK	14.662.067 lekë	kualifikuar
5. “ASI -2A CO ” SHPK	14.696.772,4 lekë	kualifikuar
6. “INFINIT” SHPK	16.469.953,68 lekë	skualifikuar
7. “GLAVENICA” SHPK	16.545.293 lekë	kualifikuar
8. “XHENGO ” SHPK	17.398.918 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 04.04.2023, është publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit.

II.5. BOE “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company SHPK (Degë e shoqërisë së huaj RSM Company) dhe “Desaret Company” SHPK” rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsye si më poshtë:

“1. Ofertuesi nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.6 ku përcaktohet shprehimisht se : 2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet; Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Konkretisht shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k (degë e shoqërisë së huaj RSM COMPANY) nuk ka dorëzuar dokumentacion që të vërtetojë se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit sipas përcaktimeve të bëra më sipër dhe në përputhje me përqindjen dhe punimet konkrete që ka marrë përsipër në Kontratën e bashkëpunimit. Kontrata me objekt Asfaltimi i rrugës Dol-Kusar-Goden-,Gjakove,Faza e II-të e zbatuar nga shoqëria RSM COMPANY sh.p.k nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit. 2. Bazuar në kontratën e bashkëpunimit shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT L04803001U është caktuar si përfaqësuese e bashkimit të shoqërive “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k dhe “Desaret Company” sh.p.k , ku ndër të tjera është caktuar që të bëjë aplikimin për procedurën e prokurimit dhe ndjekjen e procedurave online. Për sa më sipër mbështetur , në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” dhe në autorizimin e bërë para noterit datë 30.12.2022, është shoqëria “Rrugë sinjalistike

mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT L04803001U, ajo e cila duhet duhet të kishite aplikuar në APP (www.app.gov.al) për këtë procedurë prokurimi.”

II.5.1. Në datën 05.04.2023 BOE “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company SHPK (Degë e shoqërisë së huaj RSM Company) dhe “Desaret Company” SHPK nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike ka paraqitur ankesë njëherazi në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik me numër ankimi elektronik A/2023/2998 dhe me nr. 729 prot., datë 05.04.2023 ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

II.5.2. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.729/2 prot., datë 06.04.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit që BOE “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company SHPK (Degë e shoqërisë së huaj RSM Company) dhe “Desaret Company” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. protokolli 729/2023 datë 06.04.2023.

II.5.3. Nëpërmjet shkresës me nr. 729/3 prot., datë 12.04.2023, protokolluar me tonën me nr. 729/3 prot., datë 20.04.2023 me objekt “Dërgim informacioni” është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka refuzuar atë duke argumentuar: “[...] IV. Mbasi KSHA shqytoi pretendimet e ankuesit dhe dokumentacionin mbështetës arriti në përfundimet si më poshtë vijon: “Lidhur me pikën 1

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për të vërtetuar kryerjen e punëve të ngjashme rezulton se: Nga shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k si degë e shoqërisë së huaj RSM COMPANY, nuk ka dorëzuar dokumentacion që të vërtetojë se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit dhe në përputhje me përqindjen dhe punimet konkrete që ka marrë përsipër në Kontratën e bashkëpunimit. Shoqëria RSM COMPANY c cila ka aplikuar për këtë procedurë prokurimi,për të vërtetuar kryerjen e punëve të ngjashme ka dorëzuar:

1-Deklarate lidhur me dokumentat që lëshohen në Kosove

2- Kontraten datë 28.09.2016 me objekt Asfaltimi i rrugës Dol-Kusar-GodenGjakove,Faza e II-të e zbatuar nga shoqëria RSM COMPANY sh.p.k me vlerë 799650 €.

3-Faturat

4-Situacionet

5-Procesverbal i pranimit teknik dhe llogarisë përfundimtare për projektin Ky objekt nuk është i ngjashëm në tërësi me objektin e prokurimit pasi objekti që tenderohet ka të bëjë me punime në ndërtesa ndërsa kontrata e paraqitur ka të bëjë vetëm me punime rrugore.

Gjithashtu edhe zërat e punimeve që ka marrë përsipër të kryejë shoqëria “Rrugë sinjalistike

mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k nuk janë të ngjashëm me zërat e shënuar në situacionet e punimeve të paraqitura.

Në asnjë nga situacionet e paraqitura nuk u konstatuan punime në kategorinë ndërtesa dhe as punime të ngjashme me zërat që ka marrë përsipër të kryejë shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k.

Për sa më sipër pretendimi i ankuesit nuk qëndron.

Lidhur me pikën 2

Në nenin 9 pika 2 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” përcaktohet se : “2. Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.”

Nga shqyrtimi i veprimeve të kryera në sistem nga anëtarët e KVO rezulton se shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT LO4803001U është e regjistruar dhe ka llogari në faqen e APP.

Në kontratën e bashkëpunimit datë 17.03.2023 shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT LO4803001 U është caktuar si përfaqësuese e bashkimit të shoqërive “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k dhe “Desaret Company” sh.p.k , ku ndër të tjera është caktuar që të bëjë aplikimin për procedurën e prokurimit dhe ndjekjen e procedurave online.

Për sa më sipër mbështetur është shoqëria “Rrugë sinjalistike dhe Hidro Company” SHPK ajo që duhet të kishte aplikuar në APP për këtë procedurë prokurimi.”

II.6. Me memon e datës 17.05.2023 KPP ju drejtua Drejtorisë së Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës me përmbajtjen si vijon: “Pranë Komisionit të Prokurimit Publik janë protokolluar ankesat e operatorit ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro” (degë e shoqërisë së huaj RSM Company”) konkretisht përmes sistemit të ankesave elektronike me numër ankimi elektronik A/2023/2998 datë 05.04.2023 dhe me nr. 729 prot., datë 05.04.2023 si dhe përmes shërbimit postar me nr. 779 prot., datë 11.04.2023 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-60961-03-01-2023, me objekt “Qendra e Kreativitetit faza II” me fond limit 17,708,780.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.03.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se statusi i pagesës për ankesën me numër ankimi elektronik A/2023/2998 datë 05.04.2023 dhe me nr. 729 prot., datë 05.04.2023 rezulton “pa paguar” dhe fatura për arkëtim e lëshuar nga KPP për pagesën e kësaj anekese mban nr. 176.

Përmes shkresës së protokolluar me tonën nr. 771/3 prot., datë 12.04.2023 operatorit ekonomik “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro” (degë e shoqërisë së huaj “RSM Company”) ka depozituar në KPP një mandat pagesë e cila mban nr.e faturës 176 dhe që i përket faturës për arkëtim të lëshuar për ankesën me numër ankimi elektronik A/2023/2998 datë 05.04.2023 dhe me nr. 729 prot., datë 05.04.2023 dhe jo ankesës me nr. 771 prot., datë

11.04.2023. Sa më sipër lutem validimin e pagesës për ankesën me numër ankimi elektronik A/2023/2998 datë 05.04.2023 dhe me nr. 729 prot., datë 05.04.2023 dhe heqjen e saj nga ankesa me nr.779 prot., datë 11.04.2023 pasi numri i faturës 176 të cilin operatori ekonomik,ankimues e ka pasqyruar në pagesën e kryer i përket ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/2998 datë 05.04.2023.”

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company SHPK (Degë e shoqërisë së huaj RSM Company) dhe “Desaret Company” SHPK” mbi arsyen e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “1.Ofertuesi nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.6 ku përcaktohet shprehimisht se : 2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet; Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Konkretisht shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k (degë e shoqërisë së huaj RSM COMPANY) nuk ka dorëzuar dokumentacion që të vërtetojë se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit sipas përcaktimeve të bëra më sipër dhe në përputhje me përqindjen dhe punimet konkrete që ka marrë përsipër në Kontratën e bashkëpunimit. Kontrata me objekt Asfaltimi i rrugës Dol-Kusar-Goden-,Gjakove,Faza e II-të e zbatuar nga shoqëria RSM COMPANY sh.p.k nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.2 “Kapaciteti teknik” pika 2.2.1 në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me;
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

III.1.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor “Preventiv punimesh pa cmime”, përcaktohet:



PREVENTIVI
OBJEKTI: "Qendra Kreativitetit Faza II".

Nr.	Nr analize	Emertimi I punimit	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	AN-01	Prishje tavan gipsi	m2	163.5		
2	AN-02	Cmontim Korimano Druri+ Hekur (parapet)	ml	15.0		
3	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	50.0		
4	3.25/b	Gërmim dheu themele me krah h=1.5	m3	4.0		
5	3.47/1b	Mbushje ngjeshje dheu	m3	4.0		
6	2.258	Nënshtresë zhavori 50 cm	m3	2.0		
7	2.262/3	Beton M-150 shtrese e varfer,niveleuse	m3	1.0		
8	2.262/4a	Beton M-250 per trare themeli,mure xokoli,solete 0.00	m3	2.0		
9	2.167	F.V hekur betoni	ton	0.1		
10	2.182	Konstruksione metalike te thjeshta (Strehat e objekte)	ton	4.0		
11	2/401	Lyerje konstruksion metalik (Strehat e hyrjeve)	m2	80.0		
12	2.404/1	Lyerje tavani me boje hidroplastike ral	m2	450.0		
13	AN-04	Tavan me kartonxhes me hark dhe thyerje	m2	250.0		
14	2.404/1	Lyerje mure Boje hidroplastike importi cilesi e 1-re	m2	700.0		
15	AN-05	F.V dyer te brendeshme tamburate me konstruksion metali me aks rrotullimi ne qender	m2	22.0		
16	2.373/1	F V vetrate d/alumini plastike me dopio xham	m2	35.0		
17	AN-06	Porta metalike per arkiven e bibliotekes + doreza	m2	36.0		
18	AN-07	Ndarje me konstruksion metalik plus porte plus celes per bashkimin me dy ndertesave.	m2	8.0		
19	AN-08	Vendosje Ndricues i orientueshem	cope	90		
20	An-14e	Vendosje Shine per ndricues te orientueshem	cope	134		
21	2.a-135	Vendosje Ndricues tip spot me lampa fluoeshente,2x18w	cope	195		
22	AN-09	Panel polikarbonati ngjyre e bardhe	m2	50.0		
23	AN-10	Shirit led per ambient te jashtem 10-50 W	ml	60.0		
24	An-4e	F.V. Tub plastik rigidid Ø20	ml	450.0		
25	An-5e	F.V. Klema per Tub plastic rigidid Ø20	cope	200		
26	An-6e	F.V. Kthesa per Tub plastic rigidid Ø20	cope	51		
27	An -37e	F.V. Kabell UTP CAT.6E	ml	500.1		
28	AN-11	Korimano druri + konstruksion metalik	ml	25.0		
29	2.328	Patimim muri allçi (stuko)	m2	700.0		
30	2.330	Patimim tavani allçi (stuko)	m2	700.0		
31	An-12	Mure gipsi I thjeshte 10 cm	m2	200.0		
32	An-13	Porte Alumini e zeze + doreze (3 hyrjet kryesore)	m2	13.0		
33	An-14	Vetrata Alumini me xham triplex	m2	70.0		
34	An-15	Ndarje me konstruksion metalik plus porte plus celes per bashkimin me dy ndertesave.	m2	35.0		
35	An-16	Porte MDF e thjeshte RAL_	m2	10.0		
36	An-17	Veshje dritaresh me adeziv akulli	m2	100.0		
Punime Ventilimi - Arkiva e bibliotekes				Sasia	Cmimi	Vlera
1	AN_M01	F.V. Tubacione llamarine + bryla + kthesa etj.	kg	450.0		
2	AN_M02	F.V. Tubacione llamarine rrethor Ø 200 mm + bryla + kthesa etj.	m1	20.0		
3	AN_M03	F.V. Grile alumini e tipit me 2 Rreshta 30x15 cm	cope	24		
4	AN_M04	F.V.Grile alumini e tipit shiu	cope	4		
5	AN_M05	Konstruksione metalike per montimin pajisjeve dhe tabave	kg	62.5		
6	AN_M08	F.V. Tub plastik Ø 35mm + Klem per Tub plastik rigidid Ø35 + Kthesa per Tub plastik rigidid Ø35per (Kullimin e kondenses se delageshtuesve)	m1	30.0		
7	AN_M09	F.V. Tub plastik Ø 35mm + Klem per Tub plastik rigidid Ø35 + Kthesa per Tub plastik rigidid Ø35 (Per sistemin e aspirimit)	m1	210.0		
8	AN_M10	F.V. Kabell per lidhjen e pajisjeve mekanike	ml	50.0		
9	AN_M11	Zevendesimi I xhamva te dritareve me panele multistrat alumini dhe shkume poliuretani (Panel Sandwich 2 cm ral 7016)	m²	2.0		
10	AN_M12	Cmontim kangjella ekzistuese te dritareve te podrumit	cope	2		
Shuma				Shuma		
Fond rezerve			Page 1	4%	Fond rezerve 4%	

Shuma +Fond rezerve		Shuma +Fond rezerve	
T.V.SH	0.20	T.V.SH	
SHUMA			

FURNIZIM DHE VENDOSJE PAJISJE TE NDRYSHME						
				Sasia	Cmimi	Vlera
1	An -36e	FV Kamera me ngjyra per ambiente te brendshme IP, varifokal 2 MP e kompletura me te gjitha aksesoret e fiksimit dhe ushqyesin per furnizim te kameres	cope	20		
2	An -34e	FV Monitor 21" me ngjyra per sistemin CCTV	cope	1		
3	An -35e	FV Rack 22 HU, 80x80cm	cope	1		
4	An -33e	FV Video regjistrator dixhital NVR, kapaciteti min 6TB	cope	1		
5	AN-18	Rafte metalike per arkiven e bibliotekes (100x220x60)	cope	75		
6	AN-19	Rafte metalike magazina e qendres kulturore (100x220x60)	cope	20		
7	AN-20	Dollap per veglat muzikore MDF (170x220x60)	cope	10		
8	AN-21	Dollap per garderobe MDF (120x220x60)	cope	9		
9	AN-22	Rafte per zyra MDF (100x220x45)	cope	12		
10	AN-23	Tavolina (mobilim Bar-kafe)	cope	12		
11	AN-24	Tavolina zyre (75x80x160)	cope	10		
12	AN-25	Karige Tip 02 (Vizitore)	cope	120		
13	AN-26	F.V.Korrimano Druri + Aksesore montimi (Leva Baleti)	ml	40.0		
14	AN-27	F.V. Pasqyre(Baleti)	m2	40.0		
15	AN-28	Lexhio	cope	45		
16	AN-29	Varese metalike rrobash	cope	12		
17	AN-30	Banak per Bar-Kafe + veshje muri	ml	7.0		
18	AN-31	Karige tip 01 (Zyre e zeze)	cope	15		
19	AN-32	Mobilje recepsioni	ml	5.0		
20	AN-33	F.V Emerim Godine me germa metalike 3D dhe lartesi 500x70 mm	ml	5.0		
21	AN-34	Furnizim vendosje Ashensor per 8 persona + konstrukcion metalik mbajtes	cope	1		
22	AN-35	Furnizim Vendosje Ashensor per persona me aftesi te kufizuar + struktrure mbajtese	cope	1		
23	AN-36	F.V.Grila rulon per ambientet e brendshme	m2	158.0		
24	AN-37	F. Shine per ndricues te orientueshme	ml	60.0		
25	AN-38	F.Ndricues te orientueshem Tip Spot	Cope	60		
26	AN-39	F.Spot tavanor I orientueshme me suport gipsi+ Llampe 10-45W	Cope	30		
Pajisje Ventilimi - Arkiva e bibliotekes						
				Sasia	Cmimi	Vlera
1	AN_M13	F.V.Rekuperator ajri me prurje 3000 m3/h I kompletuar me rezistence elektrike dhe komanden perkatese (pult komandimi).	cope	1		
2	AN_M14	F.V.Rekuperator ajri me prurje 1000 m3/h I kompletuar me rezistence elektrike dhe komanden perkatese (pult komandimi).	cope	1		
3	AN_M15	F.V.Delageshtues profesionale te levizshem, te pajisur me depozite fikse dhe tub me pompe te integruar per largimin e ujit. Me kapacitet 500 -750 m3/h.	cope	4		
SHUMA PAJISJE						
SHUMA TOTALE						

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga BOE “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company SHPK (Degë e shoqërisë së huaj RSM Company) dhe “Desaret Company” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Deklaratë e RSM Company në të cilën deklarohet se:
“1.Në Republikën e Kosovës, Autoriteti Kontraktor nuk lëshon formularë Vlerësimi, por në përfundim të Kontratës Autoritet Kontraktor lëshon një referencë e cila është analoge me formularin e Vlerësimit
2. Në Republikën e Kosovës Autoriteti Kontraktor nuk lëshon akt kolaudimi për objektin dhe as certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve por për aktin e kolaudimit dhe certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve autoritetet kontraktore në Republikën e Kosovës lëshojnë dokumentin: Raport Përfundimtar
3. Situacioni përfundimtar sipas legjislacionit të Kosovës përfshin Faturë+Certifikatën e Zhvillimit Financiar të Kontratës+Paramasa dhe Paralogaria. Në cdo vit punë lëshohet një situacion përfundimtar që përfshin dokumentat e mësipërme.
4.Në Republikën e Kosovës, në fazën e tenderimit nuk kërkohet prokurë e posaçme por vetëm akt-marrëveshja e bashkëpunimit të operatorëve.”
- Kontratë Publike me numër identifikues: MI-16-073-5.1.1 dhe numër të kontratës 48/2016 e nënshkruar mes Ministrisë së Infrastrukturës së Kosovës dhe shoqërisë “RSM Company” me objekt “Asfalti i rrugës Dol-Kusar-goden, Gjakovë, faza II-të”, me vlerë 799,650.04 euro me TVSh.
- Vërtetim Kopje me Originalin me LRP.nr. 15274/2021 lëshuar nga noteri Z.Aliu, Lipjan me datë 17.12.2021
- Apostile lëshuar në Prishtinë me datë 10.01.2022 me nr: DCK/22-001077.
- Faturë nr. 105/16 datë 06.12.2016
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1748 datë 07.12.2016 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë nr. 29/2017 datë 25.05.2017
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr.968 datë 02.06.2017 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë 42/17 datë 04.08.2017
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1454 datë 09.08.2017 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë nr. 50/2017 datë 21.09.2017
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr: 1820, datë 02.10.2017 bashkëlidhur së cilës situacioni IV Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë nr. 30/18 datë 01.08.2018
- Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë nr. 34/18 datë 24.08.2018
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1821 datë 24.08.2018 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë nr. 39/218 datë 25.09.2018
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr: 2136 dhe datë 26.09.2018 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë 47/18 datë 10.10.2018
- Cerifikatë e zhvillimit fiannciar me referencë nr.2315 dhe datë 11.10.2018 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)

- Faturë nr. 66/18 datë 23.11.2018
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 2807, datë 27.11.2018 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë 25/19 datë 06.06.2019
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr:1192 datë 10.06.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa me paralogari e riformatuar për ndërtimin e Segmentit III të Kontratës Asfaltim i rrugës Dol-Kusar-Goden (Gjakovë) faza e II” me nr. Prok.MI -16-073-511/16, sipas projektit të Komunës së Gjakovës (Punime të mbetura)
- Faturë nr. 66/19 datë 01.11.2019
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referenca nr. 2948 datë 06.11.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë) dhe Paramasa me paralogari e riformatuar për ndërtimin e Segmentit III të Kontratës Asfaltim i rrugës Dol-Kusar-Goden (Gjakovë) faza e II” me nr. Prok.MI -16-073-511/16, sipas projektit të Komunës së Gjakovës (Punime të mbetura)
- Faturë 44/20 datë 28.10.2020
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1458, datë 02.11.2020 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë) dhe Paramasa me paralogari e riformatuar për ndërtimin e Segmentit III të Kontratës Asfaltim i rrugës Dol-Kusar-Goden (Gjakovë) faza e II” me nr. Prok.MI -16-073-511/16, sipas projektit të Komunës së Gjakovës (Punime të mbetura)
- Paramasa me paralogari e riformatuar për ndërtimin e Segmentit III të Kontratës Asfaltim i rrugës Dol-Kusar-Goden (Gjakovë) faza e II” me nr. Prok.MI -16-073-511/16, sipas projektit të Komunës së Gjakovës (Punime të mbetura)
- Faturë 46/20 datë 02.11.2020
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1487 datë 03.11.2020 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë) dhe Paramasa me paralogari e riformatuar për ndërtimin e Segmentit III të Kontratës “Asfaltim i rrugës Dol-Kusar-Goden (Gjakovë) faza e II” me nr. Prok.MI -16-073-511/16, sipas projektit të Komunës së Gjakovës (Punime të mbetura)
- Vërtetim kopje me origjinalin LRP.nr. 254/2022 lëshuar nga noteri Z.Aliu në Lipjan me datë 12.01.2022.
- Apostile lëshuar në Prishtinë me datë 13.01.2022 me nr. DCK/22-002369
- Referencë nr. 8634 prot datë 30.10.20 lëshuar nga Ministri e Infastrukturës e Kosovës, Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve me temë” “Dorëzim i procesverbalit të pranimit teknik dhe llogarisë përfundimtare për kontratën “Asfaltim i Rrugës-Dol-Kusar-Goden, Gjakovë, faza II-të”.
- Procesverbal i Pranimit Teknik dhe Llogarisë përfundimtare për projektin i Komisionit për Pranim Teknik dhe Llogari Përfundimtare për projektin: “Asfaltim i Rrugës Dol-Kusar-Goden, Gjakovë, faza II-të” (me nr. Id: MI-16-073-5.1.1 dhe nr.kontratës: 48/2016, datë 28.09.2016 i cili ka propozuar: *“Të pranohen punimet e kryera , leja e përdorimit mund të jepet nga organi kompetent meqë janë plotësuar kushtet e stabilitetit dhe sigurisë në komunikacion të fillohet me llogarinë përfundimtare të punëve të kryera”*.

- Vërtetim kopje me origjinalin LRP nr. 15275/2021 lëshuar me datë 17.12.2021 nga noteri Z. Aliu në Lipjan.
- Apostile lëshuar në Prishtinë me datë 10.01.2022 me nr. DCK/22-001074.

III.1.4. Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.5. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore

dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet; Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. [...]”*

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39 pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar*, ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE ankimues, konstatojmë, se shoqëria RSM Company me përfaqesues *“Rrugë Sinjalistikë mirëmbajtje & Hidro Company”* nuk përmbush kushtin e parë a) të vendosur nga autoriteti kontraktor për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si dhe kushtin e dytë të pikës b) të kriterit për punët e ngjashme. Kontrata Publike me numër identifikues: MI-16-073-5.1.1 dhe numër të kontratës 48/2016 e nënshkruar mes Ministrisë së Infrastrukturës së Kosovës dhe shoqërisë

“RSM Company” me objekt “Asfalti i rrugës Dol-Kusar-goden, Gjakovë, faza II-të”, me vlerë X euro me TVSh në thelb referuar objektit të saj nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit të procedurës objekt ankimi, pasi jemi përballë tipologjive të ndryshme të ndërtimeve sepse në kontratën e sipërpërmendur kemi si objekt ndërtimi e rrugëve ndërsa procedura e prokurimit konkrete ka si objekt ndërtim civil. Gjithsesi KPP në kuadër të një shqyrtimi më të thelluar administrativ me qëllim analizimin në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale të eksperiencave të dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin përcaktohen kriteret vendosi të analizoi faturat, certifikatat e zhvillimit financiar dhe të gjithë dokumentacionin provues bashkëlidhur tyre të lëshuar në zbatim të kontratës së sipërpërmendur ku që në nisje përjashtoi nga verifikimi faturat dhe dokumentacionin bashkëlidhur si; *Faturë nr. 105/16 datë 06.12.2016; Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1748 datë 07.12.2016 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë); Faturë nr. 29/2017 datë 25.05.2017; Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr.968 datë 02.06.2017 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-goden-Qafë Dobrunë); Faturë 42/17 datë 04.08.2017; Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1454 datë 09.08.2017 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë); Faturë nr. 50/2017 datë 21.09.2017; Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr: 1820, datë 02.10.2017 bashkëlidhur së cilës situacioni IV Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)* pasi këto janë punë të kryer përpara afatit të përcaktuar në kriterin e kualifikimit, pra përpara pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës objekt-prokurimi, e cila është publikuar në datë 03.03.2023. Pra, edhe pse kjo kontratë ka nisur realizimin në vitin 2016 në punët e ngjashme të dorëzuara nga “Rrugë sinjaliste mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh, janë llogaritur vetëm punët e kryera gjatë 5 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës objekt-prokurimi. Duke analizuar në këtë këndvështrim për faturat e tjera duke filluar nga fatura me nr. 30/18 datë 01.08.2018 e në vazhdimësi si dhe dokumentacioni bashkëlidhur tyre KPP vendosi të verifikojë në ballafaqim me përqindjen e punimeve të marrë përsipër nga “Rrugë Sinjalistikë mirëmbajtje & Hidro Company” dshh sipas kontratës së bashkëpunimit të datës 17.03.2023 me shoqërinë “Desaret Company” SHPK ku në pikën 2 të nenit dy të saj përcaktohet se shoqëria “Rrugë Sinjalistikë mirëmbajtje & Hidro Company” dshh do të kryejë 15% të punimeve të preventivit të objektit të punimeve” si dhe me preventivin e punëve që do të kryejë “RSM & H Company” për objektin “Qendra Kreativitetit Faza II”. Nga verifikimi preventivit të punimeve që do të kryejë “RSM & H Company” për objektin “Qendra Kreativitetit Faza II” rezulton se vlera e punimeve që do të kryejë është X lekë pa TVSH në raport me vlerën totale të ofertës së paraqitur nga BOE prej 13.270.123 lekë pa TVSH. Sërish referuar këtij preventivi Komisioni gjykon se zërat e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë “RSM & H Company” shpk (përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri “Rrugë Sinjalistikë mirëmbajtje & Hidro Company” dshh dhe që mund të konsideroheshin si punë të ngjashme zënë në preventiv një vlerë prej vetëm X lekë pa TVSH e cila në vetvete është një vlerë shumë e vogël në krahasim me zërat e tjerë të punimeve që ka marrë përsipër të kryejë RSM Company të cilët përbëjnë me shumë se 90 % përqind të vlerës së preventivit dhe që referuar faturave të lëshuara nga data 01.08.2018 e në vazhdimësi si dhe dokumentacionit bashkëlidhur tyre në zbatim të kontratës MI-16-073-5.1.1

dhe numër të kontratës 48/2016 të nënshkruar mes Ministrisë së Infrastrukturës së Kosovës dhe shoqërisë “RSM Company” me objekt “Asfalti i rrugës Dol-Kusar-goden, Gjakovë, faza II-të”, nuk rezulton që në këto fatura me dokumentacionin bashkëlidhur tyre (certifikatë e zhvillimit financiar, paramasa dhe paralogari) të ketë punë të kryera të cilat të konsiderohen të ngjashme me këto zëra. Në këtë kuadër Komisioni Gjykon se duke qenë se zërat e punimeve që RSM Company me vullnetin e saj ka marrë përsipër të kryejë sipas preventiv të punimeve dhe që mund të konsiderohen si punë të ngjashme zënë një vlerë shumë të vogël në preventiv në raport me vlerën e zërave të tjerë të preventivit të punimeve që do kryejë kjo shoqëri dhe *ku për këto zëra nuk rezulton të ketë punë të ngjashme sipas faturave të lëshuara nga data 01.08.2018 e në vazhdimësi me dokumentacionit bashkëlidhur (certifikatë e zhvillimit financiar, paramasa dhe paralogari), shoqëria “Rrugë Sinjalistike mirëmbajtje & Hidro Company” (degë e shoqërisë së huaj RSM Company) nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.2.1 në lidhje me kontratatë ngjashme për asnjërin prej dy kushteve të përmendura në kriter.*

Sa më lart pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues për skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit me arsyetimin se: *“2. Bazuar në kontratën e bashkëpunimit shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT L04803001U është caktuar si përfaqësuese e bashkimit të shoqërive “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k dhe “Desaret Company” sh.p.k , ku ndër të tjera është caktuar që të bëjë aplikimin për procedurën e prokurimit dhe ndjekjen e procedurave online. Për sa më sipër mbështetur , në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” dhe në autorizimin e bërë para noterit datë 30.12.2022, është shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT L04803001U, ajo e cila duhet duhet të kishte aplikuar në APP (www.app.gov.al) për këtë procedurë prokurimi.”* KPP vëren se,

III.2.1. Në marrëveshjen e bashkëpunimit të përkohshëm të shoqërive të paraqitur në SPE e nënshkruar me date 17.03.2023 midis shoqërisë “Rrugë Sinjalistike dhe Hidro Company” (dega e shoqërisë së huaj RSM Company) dhe shoqërisë “Desaret Company” SHPK neni 2 “Elementet e Bashkëpunimit” pika 1 ndër të tjera përcaktohet se: *“Rrugë Sinjalistike dhe Hidro Company” dshh do të ketë mundësinë të:*
-Përfaqësojë shoqërinë me qëllim aplikimin për procedurë prokurimit publik dhe ndjekjen e të gjitha procedurave online apo fizikisht deri në shpalljen fituese të bashkëpunimit nëse do të rezultojë e tillë.”

III.2.2. Referuar ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Për degët ose zyrat e shoqërive të huaja” për subjektin “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company” me NIPT L04803001U dhe përfaqësues të degës z. A.Kola forma ligjore e saj rezulton “*Degë e shoqërisë së huaj*” dhe në pikën 13 “*Të dhënat e shoqërisë së huaj*” rezulton “*14.emri i shoqërisë: RSM Company.*”

III.2.3. Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës subjekti “RSM Company” SH.P.K ka numer unik identifikimi 810802422.

III.2.4. Në nenin 3 pika 3 të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar parashikohet se:

“3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.”

Po aty në nenin 9 pika 1 dhe 2 parashikohet se:

“1. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë.

2. Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.”

III.2.5 .Duke marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të BOE ankimues, nga kthimi i përgjigjes së autoritetit kontraktor në lidhje me skualifikimin si dhe nga pretendimet e BOE ankimues në lidhje me këto pretendime KPP vëren se skualifikimi i BOE ankimues me arsyetimin se është shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT L04803001U, ajo e cila duhet duhet të kishte aplikuar në APP (www.app.gov.al) për këtë procedurë prokurimi.” nuk qëndron pasi referuar nenit 9 pika 2 të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar degët sikurse është rasti konkret “Rrugë Sinjalistike Mirembajtje dhe Hidro Company” kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë (në këtë rast me RSM Company) dhe personaliteti juridik në vetvete lidhet me mudësinë e personit juridik për të fituar të drejta por edhe për të përmbushur detyrime dhe në këtë kuptim ushtrimi i të drejtave nga shoqëria për degën, si në rastin konkret aplikimi në APP nga shoqëria RSM Company për këtë procedurë prokurimi do të konsiderohet sikur është kryer nga vetë dega paçka se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 17.03.2023 për efekt të palëve nënshkruese të marrëveshjes (“Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh dhe Desaret Company” SHPK) ndër të tjera përcaktohet se është shoqëria “Rrugë Sinjalistike dhe Hidro Company” dshh ajo që do të përfaqësojë shoqërinë me qëllim aplikimin për procedurat e prokurimit publik. Akoma më tej Komision vëren se vëren se duke u referuar në të dhënat e ekstraktit të regjistrimit tregtar për shoqëritë e huaja rezulton se përfaqësuesi ligjor i degës “Rrugë Sinjalistike Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh është i njëjtë me përfaqësuesin ligjor të shoqërisë së huaj RSM Company. Gjithashtu KPP vëren se aplikimi në sistemin e prokurimeve elektronike të APP-së nga shoqëria RSM Company është kryer me numër identifikimi të subjektit 810802422 i cili bazuar në të dhënat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës përputhet me numrin e identifikimit të subjektit RSM Company cfare tregon se aplikim në sistemin e APP-së është kryer nga shoqëria e huaj për degën e saj në Shqipëri dhe në kuptim të dispozitave ligjore të sipercituara për shkak se shoqëria dhe dega gëzojnë të njëjtin personalitet juridik ky veprim i kryer nga shoqëria RSM Company është një veprim ligjor dhe pretendimi i BOE ankimues qëndron.

Sa më lart pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues me nr. 771 prot., datë 11.04.2023 nga BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar dhe për të njëjtat arsye skualifikimi si në ankesën e paraqitur përmes sistemit të ankesave elektronike me numër ankimi elektronik A/2023/2998 dhe me nr. 729 prot., datë 05.04.2023 KPP vëren se mandat pagesa e paraqitur në KPP nga shoqëria RSM e protokolluar në KPP përmes shkresës me nr.771/3 prot., datë 12.04.2023 mban numrin e faturës për arkëtim 176 që i përket ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/2998 dhe me nr. 729 prot., datë 05.04.2023 dhe jo ankesës me nr. 771 prot., datë 11.04.2023. Për këtë përmes memos së dates 17.05.2023 ju kërkua Drejtorisë së Monitorimit Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës në KPP validimi i faturës të ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/2998 dhe me nr. 729 prot., datë 05.04.2023 ku statusi i pagesës për këtë procedurë deri në ato momente rezultonte “pa paraqitur mandat pagesë” dhe heqjen e saj nga ankesa me nr. 771 prot., datë 11.04.2023 pasi numri i faturës 176 të cilin operatori ekonomik, ankimues e ka pasqyruar në pagesën e kryer i përket ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/2998 datë 05.04.2023. Në këtë kuadër pavarësisht se ankesa me nr. 771 prot., date 11.04.2023 është paraqitur nga i njëjti operator ekonomik, për të njëjtën procedurë prokurimi dhe për të njëjtat arsye skualifikimi duke qenë se kjo ankesë pas ndryshimeve të kryera si më sipër nga specialisti i financës rezulton tashmë edhe pa pagesë prandaj ajo nuk do të merret në shqyrtim nga KPP, për mosplotësim të kushteve formale të saj ku njëri prej të cilëve është paraqitja pranë KPP e pagesës së faturës financiare.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK me numër ankimi elektronik A/2023/2998 dhe me nr. 729 prot., datë 05.04.2023 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-60961-03-01-2023, me objekt “Qendra e Kreativitetit faza II” me fond limit 17,708,780.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.03.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

2. Të mos pranojë ankesën e BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK me nr. 771 prot., datë 11.04.2023.
 3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK për ankesën me numër ankimi elektronik A/2023/2998 dhe me nr. 729 prot., datë 05.04.2023.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

